

KUMTESA DHE SHENIME

DODONA DHIMA

RRETH BOTIMEVE TË VEPRAVE TË NAIM FRASHËRIT

Në historinë e prodhimit poligrafik Naim Frashëri është autori që ka lënë trashëgimin më të madh botues të periudhës së Rilindjes. Bibliografia e këtij trashëgimi paraqet interes për studimin e poetit tonë kombëtar dhe pasqyron vlerësimin që i bëhet figurës së tij në periudha të ndryshme të historisë së letërsisë shqipe.

Gjatë 18 vjetve të prodhimitarisë botuese Naimi la 20 vepra (të njohura prej nesh¹⁾ prej të cilave 15 vepra në gjuhën shqipe dhe 5 në gjuhët e huaja: turqisht, greqisht, persisht. Nga këto 17 janë origjinale, ndërsa 3 janë përkthime ose adaptime nga literatura e huaj. Veç veprave të plota Naimi botoi në rev. «Drita» dhe «Dituria», gjatë dy vjetve, 15 artikuj mbi dituritë, 18 vjersha dhe 23 prralla në vjersha të adaptuara nga La Fonteni. Qyteti ku u botuan më tepër veprat e Naimit është Bukureshti, këtu u shtypën 15 vepra, në Stamboll 4 dhe në Sofie 1. Veprat në gjuhën shqip i ka nënshkruar me inicialet N.H.F., me përjashtim të botimeve në rev. «Drita» dhe «Dituria» që ka përdorur nënshkrimin D, kurse veprat në gjuhë të huaj i ka nënshkruar me M. Neim ose M. Naim Frashëri që, do të thotë Mehmet Naim Frashëri, dhe me Δ (delta greke) O alithis pothos ton shqiptaron (Dëshira e vërtetë e shqiptarëve).

Në veprimtarinë botuese të kohës Naim Frashëri nuk njihet vetëm si autor, por dhe si njëri nga udhëheqësit e kësaj veprimtarie. Nxjerr lejet për botimin e librave shqip, merret me korrekturat dhe ndonjëherë i përpunon veprat shqipe, interesohet për shtypjen e librave të shkollës dhe dërgimin e tyre në destinacionin e duhur dhe, së fundi, lufton që librat në gjuhën shqipe të shtypen me alfabetin e Stambollit.

Pra studimi i figurës së Naimit paraqet një interes të veçantë jo vetëm si poet e patriot por dhe në fushën e historisë së librit dhe të bibliografisë shqiptare.

* * *

Kronologjia e botimit të veprave të Naimit na lejon të bëjmë një grupim të botimeve në tre faza simbas intensivitetit dhe cilësisë së botimit.

1) Nga *Kasbar kütüphanesi esami i kütübi*, Istambul 1896, f. 39 dhe *Millî kütüphanede mevcut arap harfli türkçe kitapların muvakkat katalogu II Cilt-1 Fas*. M. Ankara, 1967, f. 870, kemi të dhëna se Naim Frashëri ka botuar dhe dy vepra të tjera, *Kënga e parë e Iliadhës së Homerit*, turqisht bot. i 1896 dhe tjetra një *Gramatikë e persishtes në gjuhën turke*; botim i dytë i së cilës është bërë në vitin 1887.

Mbas përgatitjes së këtij materiali, konsultuam studimin e H. Kaleshit në «Gjurmime albanologjike», 1970, nr. 1-2. Në f. 144 dhe 152, citohet se botimi i parë gramatikës së persishtes është në vitin 1871 dhe po aty përmendet një vepër jetër persisht e paverifikuar nga autori i studimit me titull *Sahanân-i bergüzide*.

Faza e parë 1882-1885. Aktivitetin botues Naimi e fillon në vitin 1882 kur largohet nga Shqipëria dhe vete në Stamboll. Botimet e para të kësaj faze janë në gjuhën turke, e para me titull Hitirat ve keşfiyyat (Shpikjet dhe zbulimet), botuar më 1882 dhe e dyta Fusuli Erbea (4 stinat), botuar më 1884. Të dyja veprat janë përkthime dhe adaptime nga frengjishtja dhe bëjnë pjesë në serinë e «Bibliotekës së xhepit», të krijuar nga Samiu. Më 1884 nxjerr lejën e botimit të revistës «Drita» dhe «Dituria» në të cilat Naimi ka shkrimet më të shumta. Me mbylljen e «Diturisë (1885) Naimi boton «Tekhayylat» (Endërrimet) një përmbledhje vjershash persisht². Kjo është faza e parë e botimeve dhe e veprimtarisë së Naimit, fusha e së cilës është Stambolli.

Faza e dytë 1886-1888. Kjo është faza më intensive e veprimtarisë botuese të Naimit. Kur Stambolli ia mbylli dyert librit shqip, autorët shqiptarë dhe përkrahësit e tyre i kthyen sytë nga Bukureshti. Më 1886 dalin nga shtypshkronja e Shoqërisë së Bukureshtit, degë e Stambollit, me radhë, «Bagëti e Bujqësia» librat e shkollës: «E këndimit çunavet, këndonjëtorja», copë e parë dhe e dytë, «Istori e përgjithëshme» «Vjersha për mësonjëtorët e para» «Dituritë» (kjo e fundit u botua më 1888) dhe veprën në gjuhën greqisht «O alithis pothos ton shqipëtaron» (Dëshira e vërtetë e shqiptarëve)³. Nga të 10 veprat që ushtypën në Bukuresht më 1886, 6 qenë të Naimit, 2 të Vretos e 2 të Samiut.

Megjithëse kjo fazë është më intensive në sasinë e veprave dhe në tirazhin e tyre, sepse veprat e shkollës janë shtypur me një tirazh mbi 2000 kopje, cilësia e botimit është më e ulët. Korrektimi i bocavet bëhej nën drejtimin e Jani Vretos, por radhitësit ishin të huaj, prandaj dhe veprat dilnin me shumë gabime. «Istori e përgjithëshme», ku shënohet radhitës një rumun, ka 23 gabime dhe «Dituritë» 129 gabime.

Faza e tretë 1890-1899. Në këtë dhjetëvjeçar shtypen 10 vepra të Naimit. Më 1890 botohet «Lulet e verës» dhe mbas një ndërprerjeje trivjeçare, nga 1894 deri më 1898, botohen çdo vit nga 2 vepra, duke përjashtuar vitin 1897. Më 1894 «Mësime» dhe «Parajsa dhe fjala fluturake»: më 1895 «O eros» (Dashuria) dhe «Gjithësia»; më 1896 «Iliadh'e Omirit» dhe «Fletore e Bektashinjet»; më 1898 «Istori'e Skënderbeut» dhe «Qerbelaja»; kurse më 1899 botohet vetëm një vepër «Istori e Shqipërisë» që është dhe vepra e fundit e Naimit e botuar me gjalljen e tij. Kjo fazë na dëshmon për një ngritje të volumit dhe për një cilësi më të lartë të botimit. Ndërsa në fazën e parë, të tria veprat e botuara dhe shkrimet e «Dritës» dhe të «Diturisë» arrijnë në 271 faqe dhe 167 shtylla, dhe në fazën e dytë 572 faqe, në fazën e tretë arrijnë në 1288 faqe, pra më tepër se dyfishi i fazës së dytë.

Veprat e kësaj faze janë më të goditura; mjaft prej tyre, nga ana e përmbajtjes, tregojnë ngritjen dhe pjekurinë e talentit të poetit dhe dallohen për larminë e temave. Kur u botua «Istori e Skënderbeut» më 1898, Çajupi i shkruan nga Misiri po atë vit Visar Dodanit t'i dërgojë dy kopje të «Istorisë së Skënderbeut» të Naim Frashërit⁴, që tregon se tashmë njëhej krijimi i Naimit, sepse ai e kishte formuar personalitetin e

2) Në Bibliotekën kombëtare tashti ndodhen 3 kopje të kësaj vepre, kurse në vitet e para të çlirimit kjo vepër quhej si e rrallë.

3) Kjo vepër u përkthye shqip nga Kristo Floqi dhe për herë të parë u botua shqip më 1904 në Sofje.

4) V., Dodani, *Memoriet e mia*, Konstancë, 1930, f. 109.

tij letrar, kurse dijetari frëng Lyis Benlëvi për këtë vepër ka thënë se shqiptarët tashti kanë Iliadhën e tyre.

Edhe nga paraqitja e botimit këto vepra janë të një niveli më të lartë nga fazat e tjera. Përmbajnë ilustrime dhe vedeta, kushtime dhe citate, bëhen njoftime në shtypin e kohës për botimin e tyre dhe kanë shumë më pak gabime me përjashtim të veprës «Parajsa dhe fjala fluturake», që është shtypur e lidhur së bashku me veprën «Mësimet» dhe numërtimin e faqeve e fillon nga numri 61. Megjithëse këto janë dy vepra të veçanta, ato duke u dërguar së bashku, me sa duket, janë kuptuar nga shtypshkronja si një vepër e vetme.

Në kurriz të faqes së titullit të veprës «Parajsa dhe fjala fluturake» është vënë citati në gjuhën frëngjisht që Shqipëria ka qenë vendi i heronjvet, ku Homeri gjeti, thotë, Akilin, Greqia Aleksandrin, Papa Eugjeni IV Skënderbeun.

Përsa i përket vendit të botimit në këtë fazë predominon Bukureshti: 8 vepra shtypen në Bukuresht, 1 në Stamboll dhe 1 në Sofje.

*

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në dinamikën e prodhimit të Naimit janë:

Së pari, faktorë historikë të diktuar nga nevoja imediate të lëvizjes kombëtare. Më tepër se çdo autor tjetër i Rilindjes Naimi me penën e tij ju përgjigj nevojave më të ngutshme të lëvizjes. 1886-a është viti më intensiv i botimit të veprave të Naimit, sepse në këtë vit çështja më e ngutshme ishte plotësimi i nevojave për hapjen e shkollave shqipe. «Kanonizmoi» i shoqërisë së Bukureshtit theksonte se qëllimi dhe detyrat kryesore të kësaj shoqërie do të ishin shtypja e librave dhe hapja e shkollave dhe se pa u botuar librat e nevojshme të mos hapeshin shkollat. Po ashtu kryetari i shoqërisë Anastas Lakçja, milioneri shqiptar, të cilit Naimi i ka kushtuar veprën «Bagëti e bujqësia», premonte se do të jepte një fond nga pasuria e tij për hapjen e shkollave shqipe në Korçë. Po as nenet e kanonizmoit, as milionat e pasanikëve nuk e vunë në lëvizje maqinën e shoqërisë. Ajo mori frymë dhe u ngjall e jetoi me veprat e Naimit e të patriotëve të tjerë mbas 5 vjetësh të themelimit të saj.

Edhe periudha e fundit e veprimtarisë botuese të Naimit kondicionohet nga një ngritje e re e lëvizjes kombëtare, së cilës Naimi i përgjigjet me vepra të tilla si «Istori e Skënderbeut» dhe «Istori e Shqipërisë».

Së dyti, janë faktorë të mundësisë së botimit në gjuhën shqipe. Në Bukuresht, larg intrigave të Stambollit, Naimi gjeti terrenin më të favorshëm për botimin e veprave të tij. Tradita e së kaluarës tek shqiptarët e Bukureshtit dhe përsëri nevojat e lëvizjes kombëtare i mobilizuan ata të shtojnë përpjekjet për të krijuar kushtet për botimin e librave shqip. Me ndihmat e shqiptarëve porosisin një shtypshkronjë në Vienë dhe para ardhjes së saj shtypin «Këndonjëtoren» me një pedalinë të blerë nga një gazetë rumune.

Naimi tek shoqëria e Bukureshtit gjeti një mbështetje të fortë. Në letrën e datës 16 maj 1887 Samiu dhe Naimi porosisin: «Shoqëria e Bukureshtit është nevojë të jetë e pareshturë, fletoret (librat) ka dhe më gati, edhe të tjera po bëhen, andaj shtypshkronja të mos mbylletë kurrë po të jetë hapur gjithënjë se kjo do ta bëjë Shqipëtarë të mbaruar»⁵.

5) V. Dodani, *Memoriet e mia*. Konstancë, 1930. f. 47.

Së treti, faktorë politikë të qëndrimit të qeverisë turke ndaj shkrimt shqip. Megjithëse qeveria turke më 1879 aprovon themelimin e «Shoqërisë së shtypurit shkronja shqip» në Stamboll, më 1881-82, nga ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit ajo ndalon shtypjen e librave shqip. Prandaj Naimi në këtë kohë boton vepra në gjuhën turke. Po kështu më 1885, kur qeveria turke dha urdhër për të mbyllur revistën «Dituria», Naimi përsëri boton në gjuhë të huaj, persisht, «Tekhayylat». Mbas vitit 1885 Naimi i humbi shpresat për ta botuar lirisht veprën e tij në gjuhën shqipe në Stamboll, prandaj dhe kërkon rrugëdalje në Bukuresht. Me këtë faktor lidhet dhe nënshkrimi i veprave në gjuhën shqipe pa emrin e plotë të autorit.

Megjithatë dhe veprat në gjuhë të huaj nuk janë të shkëputura, qoftë edhe nga kërkesat e lëvizjes kombëtare, siç është «O alithis pothos ton Shqipëtaron» (Dëshira e vërtetë e shqipëtarëve), qoftë nga veprimtaria e tij si iluminist, siç është vepra «Hitiraat ve keşfiyyat (Shpikjet dhe zbulimet). Për të bërë një paralelizëm midis kohës të së shkruarit të veprave dhe kohës së botimit, nuk kemi të dhëna të sakta, por disa burime biografike dhe tipografike na japin këto të dhëna:

1. Para vitit 1881 është njohur vjersha «Shqipëria», e cila ka qarkulluar si fletë volante tek shqiptarët e mërgimit. Botimi i saj për herë të parë tek revista «Albania» e Brukselit më 1897 u muar nga një dorëshkrim i Bukureshtit. Megjithëse kjo vjershë ka qenë shumë e përhapur, ende nuk na ka rënë në dorë ndonjë autograf ose kopje e saj.

2. Krijimet e botuara në revistën «Drita» dhe «Dituria» mendohet të jenë shkruar gjatë viteve 1884-1885. Këto i gjejmë të botuara më vonë në vepra të veçanta të Naimit si p.sh. vjershën e parë «Qiriri» e gjejmë të botuar më vonë tek «Vjersha për mësonjëtoje të para» më 1886 me titull «Fjalët e qiririt».

3. Vjershat persisht të përmbledhura dhe të botuara në «Tekhayylat» më 1885 janë krijime të viteve 1871 deri 1881, dmth. të periudhës para se Naimi të vinte në Stamboll dhe t'i kushtohej kryekëput çështjes kombëtare.

4. Veprat e fundit si «Istori e Skënderbeut», «Istori e Shqipërisë», etj. duhet të jenë shkruar deri më 1895, sepse mbas këtij viti Naimin e vuri poshtë sëmundja dhe ai nuk krijoi më.

Vepra e Naimit vazhdoi të botohej edhe mbas vdekjes së tij, në fillim në Sofje e Selanik dhe më vonë në Shqipëri.

Po vendi i merituar në historinë e librit shqiptar Naimit ju dha mbas çlirimit, në periudhën e pushtetit popullor, ku Partia i vlerëson drejt traditat patriotike dhe kulturele të së kaluarës.